



**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°31/2022

Hagë, 01/09/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi mbajtjen e konferencës së ardhshme për ecurinë në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi* për të enjten, 8 shtator, në orën 13:30, dhe u kërkoi palëve dhe mbrojtësit të viktimave të dorëzojnë parashtrimet e tyre me shkrim, nëse kanë, para seancës dhe jo më vonë se të hënën e ardhshme.

Ndër pikat e rendit të ditës të seancës së të enjtes së ardhshme, gjykatësi ka kërkuar përditësime në lidhje me ecurinë e nxjerrjes së provave prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Mbrojtjen, ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes dhe nëse mbrojtësi i viktimave ka ndërmend të paraqesë prova.

Më 26 gusht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin mbi kërkesat e ekipeve të Mbrojtjes për apelimin e disa pikave në lidhje me trajtimin e informacionit konfidencial dhe kontaktet me dëshmitarët. Në këtë vendim, gjykatësi miratoi leje për apelimin e disa pikave dhe gjithashtu rrëzoi kërkesën për apelimin e disa pikave të tjera.

Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës caktoi panelin e Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e këtyre apeleve.

Në gjykimin e Salih Mustafës, Trupi Gjykues ka caktuar rendin e ditës për deklaratat përmbyllëse.

Rendi i ditës, që mund të ketë ndryshime, saktëson se Prokuroria do ta jap deklaratën përmbyllëse më 13 shtator, vijuar prej deklaratave të mbrojtëses së viktimave dhe

1





**Informim javor për median
Dhomet dhe Zyra Administrative**

N°31/2022

Hagë, 01/09/2022

Mbrojtjes më 14 shtator. Përgjigjet, pyetjet nga Trupi Gjykues dhe deklaratat e të dyja palëve në lidhje me zhdëmtime janë planifikuar të behen më 15 shtator.

Dje, gjykatësi Mihael Bolander i dorëzoi Kryetares Ekaterina Trendafilova dorëheqjen e tij si gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Gjykatësi Bolander, i cili dha dorëheqje për arsye personale, deklaroi se ndihej i nderuar që kishte shërbyer si gjykatës i DHSK-së.

Kryetare Trendafilova shprehu mirënjohjen e saj të sinqertë për kontributin e gjykatësit Bolander në mandatin e DHSK-së, përfshirë edhe, së fundmi, si anëtar i panelit të parë të Gjykatës Supreme.

Dëshirojmë t'ju kujtojmë të gjithë studentëve të interesuar të drejtësisë në Kosovë se afati për dorëzimin e eseve në kuadër të konkursit të eseve të DHSK-së është 30 nëntori. Studentët mund ta zgjedhin vetë temën, me kusht që ajo të jetë nga fusha e drejtësisë dhe të ketë lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës. Esetë mund të dorëzohen në cilëndo nga tri gjuhët zyrtare të gjykatës: shqipe anglishte ose serbishte. Më shumë informacion mund të gjeni në faqen tonë të internetit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

